GEFF - Ballkani Perëndimor - Raiffeisen Bank Kosovo

Lokacioni: Kosova

Numri i projektit: 50507

Sektori i biznesit: Institucionet financiare

Lloji i njoftimit: Privat

Kategoria mjedisore: IF

Data e aprovimit: 22 dhjetor 2020

Statusi: **I miratuar**

DPP e shpalosur në gjuhën angleze: 22 dhjetor 2020

Sipas nenit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informatë: "Për Projektet e aprovuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve e ka deleguar autoritetin e aprovimit, DPP-ja do t'i shpaloset në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për mos-kundërshtim shtetit anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH".

Përshkrimi i projektit

Kredi seniore e pasiguruar deri në 5.0 milion EUR që do të jepet në dy transhe (transhi i parë prej 1.25 milion EUR dhe transhi i dytë prej 3.75 milion EUR) për Raiffeisen Bank Kosovo SHA ("RBKO") nën Mekanizmin për Financimin e Ekonomisë së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor ("GEFF BB").

Objektivat e projektit

Transaksioni përkrahë investime në teknologji, materiale dhe solucione të efiçiencës së energjisë me performancë të lartë që ndërmerren në ose në lidhje me vendbanimet private ose ndërtesat rezidenciale ("nën-projekte") në Kosovë. Nën-projektet përzgjidhen sipas kritereve të pranueshmërisë teknike dhe financiare të përcaktuara në deklaratën e politikave për GEFF BB. 100% e shfrytëzimit të mjeteve do të lidhet me investimet e Tranzicionit të Ekonomisë së Gjelbër.

Ndikimi i tranzicionit

Nota ETI: 80

Projekti i kontribuon objektivave të GEFF BB, duke i përkrahur cilësitë **e Gjelbra** dhe **Konkurruese** të TI.

Gjelbër: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një ekonomie të gjelbër duke lehtësuar zgjerimin e huadhënies për investime në teknologjitë e efiçiencës së energjisë rezidenciale me performancë të lartë. Linjat inovative të financave të disponueshme përmes institucioneve financiare lokale do të ndihmojnë në adresimin e sjelljes së ngulitur dhe të demonstrojnë rastin e biznesit për investime në teknologji me performancë më të lartë për përfituesit, IFP-të dhe pjesëmarrësit tjerë të tregut, duke krijuar kështu kërkesë të gjelbër për investime.

Konkurrues: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një sektori financiar më konkurrues duke ndërtuar kapacitetin e IFP-ve për financimin e projekteve të ekonomisë së gjelbër. Për më tepër, futja e produkteve të huazimit bazuar në kërkesat e efiçiencës së energjisë që tejkalojnë standardet mbizotëruese stimulojnë zhvillimin e tregut dhe furnizimin e teknologjive të gjelbra, materialeve dhe shërbimeve me performancë të lartë.

Informatat për klientin

RAIFFEISEN BANK KOSOVO SHA

RBKO, filial i Raiffeisen Bank International ("RBI"), është banka më e madhe komerciale në Kosovë me 1,022 milion EUR në asete totale në VE 2019 (23.3% të totalit të sistemit). RBKO e ka selinë në Prishtinë dhe e ka rrjetin më të madh në shtet me 45 degë dhe 870 të punësuar deri në VE 2019. Operon si filial në pronësi të plotë të RBI me rejting A3 (stabil) nga Moody's dhe A- (negativ) nga S&P.

Përmbledhje e financimit nga BERZH

5,000,000.00 €

Kostoja totale e projektit

5,000,000.00 €

Shtueshmëria

Shtueshmëria arrihet duke kombinuar financimin e nevojshëm afatgjatë përmes RBKO me Bashkëpunimin Teknik ("TC") dhe grantet për investime në një paketë që promovon investimet e ekonomisë së gjelbër rezidenciale në Kosovë.

Përmbledhje Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar IF (PMS 2019). Pyetësori i plotësuar për kujdesin e duhur të BERZH për M&S nga Raiffeisen Bank në Kosovë konfirmoi se klienti implementon sistemin e menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS) në të gjithë organizatën e RBI. Pas përcaktimit të Kërkesës për Performancë 9, paragrafi 8, BERZH do të pranojë aplikimin e Standardeve të Performancës së IFC-së për këtë transaksion (më konkretisht, Paktet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore/MIGA) të cilat kryesisht janë në përputhje me KP-të e BERZH-it; megjithatë klienti do të duhet të implementojë dispozita shtesë

të M&S BERZH siç janë lista e Përjashtimit të BERZH, përkufizimi i Kategorisë A dhe kërkesa për referim, si dhe pajtueshmëria me KP2/4. Nga RBKO gjithashtu do të kërkohet që të ndërmerr një ekzaminim të riskut të M&S për ekspozime nën 5 milion EUR (aktualisht nuk kërkohet nga dispozitat e IFC/MIGA). RBKO do t'i raportojë BERZH-it në baza vjetore për çështjet e M&S.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Grantit

Bashkëpunimi Teknik (TC): 5.1 milion EUR janë siguruar për të përkrahur përgatitjen, implementimin dhe monitorimin e GEFF BB. RBKO do të ndajë deri në 15% të kostove të TC që i përfitojnë ata drejtpërdrejt përmes një fushate marketingu, njësoj si për linjat tjera të GEFF në rajon. Burimet e granteve sigurohen nga Republika e Austrisë dhe Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor e financuar nga shumë donatorë për të financuar programin e TC nën GEFF.

Jo-TC: 1.03 milion EUR për grante investimi për nën-huamarrësit për implementimin e nën-projekteve të pranueshme në përputhje me Deklaratën e Politikave. Grantet jepen nga Bashkimi Evropian.

Informatat kontaktuese të kompanisë

Bajram Krasniqi
bajram.krasniqi@raiffeisen-kosovo.com
+383 (0) 38 222 222 319
www.raiffeisen-kosovo.com
99 Robert Doll St. 10000 Prishtina Kosovo

Përditësimi i fundit i DPP

22 dhjetor 2020

Kuptimi i tranzicionit

Informata të mëtejshme në lidhje me qasjen e BERZH-it për ta matur ndikimin e tranzicionit janë në dispozicion këtu.

Mundësi biznesi

Për mundësi biznesi ose prokurim, kontaktojeni kompaninë e klientit.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktojeni:

Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projekte në sektorit shtetëror, vizitojeni Prokurimin e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetjet e përgjithshme

Pyetjet specifike mund të shtrohen duke e përdorur formularin e Pyetjeve të BERZH-it.

Politikat Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kërkesat e Performancës (KP) i përcaktojnë mënyrat se si BERZH i implementon zotimet e veta për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe KP-të përfshijnë dispozita specifike ashtu që klientët të jenë në përputhje me kërkesat e aplikueshme të legjislacionit kombëtar për informimin dhe konsultimin publik, si dhe t'i krijojnë mekanizmat e ankesave pranimin dhe lehtësimin e zgjidhjes së brengave dhe ankesave të hisedarëve, posaçërisht sa i përket performancës mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e risqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit, BERZH kërkon gjithashtu që klientët e tij t'i shpalosin informatat, siç kërkohet, në lidhje me risqet dhe ndikimet që rrjedhin nga projektet ose të ndërmarrin konsultim domethënës me hisedarët, t'i shqyrtojnë dhe t'i përgjigjen opinioneve të tyre.

Më shumë informata për praktikat e BERZH-it në këtë drejtim jepen në PMS.

Integriteti dhe pajtueshmëria

Zyra e Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmëri (ZZKP) në BERZH promovon qeverisje të mirë dhe siguron se aplikohen standardet më të larta të integritetit në të gjitha aktivitetet e Bankës në pajtueshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare. Kujdesi i duhur i integritetit kryhet për të gjithë klientët e Bankës për të siguruar se projektet nuk paraqesin integritet të papranueshëm ose risk për reputacionin e Bankës. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e çështjeve në fazat e aprovimit të vlerësimit të projektit është mënyra më efektive për ta siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. ZZKP luan rol kyç në punën mbrojtëse, dhe ndihmon në monitorim të risqeve ndaj integritetit në projektet pas investimit.

ZZKP është gjithashtu përgjegjës për hetimin e pretendimeve të mashtrimit, korrupsionit dhe sjelljes së pahijshme në projektet e financuara nga BERZH. Kushdo, brenda ose jashtë Bankës, që dyshon për mashtrim ose korrupsion duhet ta parashtrojë kallëzimin me shkrim pranë Zyrtarit Kryesor të Pajtueshmërisë në email në compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e kallëzuara do të trajtohen nga ZZKP. Të gjitha kallëzimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Kallëzimet mund të bëhen në çdo gjuhë të Bankës ose të shteteve ku operon Banka. Informatat e dhëna duhet të jenë në mirëbesim.

Politika e qasjes në informatë (PQI)

PQI përcakton se si BERZH i shpalosë informatat dhe konsultohet me hisedarët për ta promovuar vetëdijesimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operimeve të tij pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2020. Luteni që ta vizitoni faqen e Politikave të Qasjes në Informatë për të zbuluar se çfarë informata janë në dispozicion nga uebsajti i BERZH.

Kërkesat specifike për Informatë mund të shtrohen duke e përdorur formularin e Pyetjeve të BERZH-it.

Mekanizmi i pavarur i projektit për llogaridhënie (MPPLL)

Nëse përpjekjet për t'i adresuar brengat e shpalosjes mjedisore, sociale ose publike me Klientin ose Bankën janë të pasuksesshme (p.sh., përmes mekanizmit të ankesave në nivelin e Projektit të Klientit ose përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me menaxhmentin e Bankës), individët dhe organizatat mund të synojnë t'i adresojnë brengat e tyre përmes Mekanizmit e pavarur të projektit për llogaridhënie (MPPLL) të BERZH-it.

MPPLL i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet e projektit për të cilat besohet se kanë shkaktuar (ose ka gjasa që të shkaktojnë) dëm. Qëllimi i mekanizmit është që ta përkrahë dialogun ndërmjet hisedarëve të projektit për t'i zgjidhur çështjet e shpalosjes mjedisore, sociale dhe publike; të konstatojë nëse Banka ka qenë në pajtueshmëri me politikat e saj mjedisore dhe sociale ose dispozitat specifike të Projektit të Politikave për Qasjen në Informatë; dhe kur lypset, ta adresojë çdo mospajtueshmëri ekzistuese të këtyre politikave, duke parandaluar mospajtueshmërinë e ardhshme nga Banka.

Luteni që ta vizitoni uebfaqen e Mekanizmit të pavarur të projektit për llogaridhënie për të mësuar se si parashtrohet kërkesa për shqyrtim përmes formës konfidenciale online, me email, postë ose telefon. MPPLL është në dispozicion për t'i diskutuar brengat tuaja dhe t'u përgjigjemi pyetjeve që mund t'i keni në lidhje me parashtrimin ose trajtimin e Kërkesave të cilat i ndjekin Politikat e projektit për llogaridhënie dhe Udhëzuesin. Identiteti i kërkuesve mund të mbahet konfidencial, sipas kërkesës.